



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**A nr. 150/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić, dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike të Kosovës (LDK), dega në Ferizaj për shkak të vendosjes se posterit në vendet publike, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 05.10.2013, mori këtë:

**VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj.

**Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.10.2013, nga subjekti politik PDK dega në Ferizaj, me të cilën pretendohet se kandidati për asamble komunale Zyfer Krasniqi nga subjekti politik LDK, ka vendosur posterin në shenjën e komunikacionit në rrugën “Sali Shabani”, me të cilin veprim sipas parashtrusit të ankesës është bërë shkelje e Rregulles ligjore nr 01/2012, Për Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjobave neni 3 pika 2 si dhe Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike neni 4 pika b). Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur dy fotografi si dëshmi nga vendi i ngjarjes.

PZAP-i, e informoi subjektin politik LDK në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 04.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 05.10.2013, në ora 12:00, PZAP-i, mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik LDK sipas afatit të caktuar, ku në përgjigje në ankesë theksohet se ankesa e ushtruar ndaj subjekti politik të LDK-së është e pa bazë nga fakti se foto e ofruar si provë tregojnë se posterat nuk janë të vendosura në shenjat e komunikacioni siç thuhet në ankesë, por shenja e komunikacionit është e vendosur në shtyllë elektrike si dhe në foto shihet se nuk është prekur shenja e komunikacionit.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

**ankesa është e pabazuar**

Pretendimet ankimore se posterit i kandidatit për asamble komunale Zyfer Krasniqi në Ferizaj nga subjekti politik LDK, është i vendosur në shenjë të publike të trafiku

nuk qendërojnë ngase nga fotografia e bashkangjitur si provë nga parashtruesi i ankesës PZAP-i konstatoi se posteri i kandidatit të lartpërmendur është i vendosur në shtyllë elektrike e jo siç pretendohet në ankesë. Andaj në kuptim të nenit 115.1 lidhur me 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur PZAP-i vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë**

Anr. 150/2013 më datën 05.10.2013

**Kryesuesi i Panelit  
Nehat Idrizi**



***Udhëzim Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*